



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 269/5 Prot

Tiranë më 29.04. 2015

**V E N D I M**

Nr 45, datë 29/04/2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil  
Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike,

**VËREJ SE:**

Në zbatim të vendimit nr. 11, datë 10.02.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur kryesisht, fillimin e mbikëqyrjes tematike, për administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i mbikëqyrjes është kufizuar në disa institute të ligjit, ndër të cilat deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit e institucionit që kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si detyrim i parashikuar në mënyrë të shprehur në dispozitat tranzitore të ligjit; respektimi i kërkesave të përgjithëshme për pranimin në shërbimin civil; përshkrimi i punës për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil sipas formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji, si dhe probleme të tjera që lindin gjatë zbatimit në praktikë të ligjit.

Mbikëqyrja është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 164/2 prot., datë 10.02.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 164/1 prot., datë 10.02.2015 "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes".

Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit (Agjencisë) dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, si dhe me observacionet e paraqitura nga punonjësi i përmendur në materialin paraprak të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 2173, datë 24.03.2015 "Mbi projektraportin e KMSHC", të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Po kështu, komente në lidhje me aspekte të veçanta të mbikëqyrjes, ka paraqitur edhe Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1096/1, datë 31.03.2015 "Kthim përgjigje", të cilat janë trajtuar në pjesët respektive të raportit, që përkojnë me observacionet.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të kryer në institucionin, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Të përfundojë verifikimi i gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe të materializohet procesi në dosjen e personelit.
3. Të plotësohet dosja e personelit, në rastet e konstatuara me mungesa, në anekstraportet, të cilat janë pjesë e këtij vendimi.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
5. Me kalimin e këtij afati, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e mara për zbatimin e këtij vendimi.

6. Për këtë vendim të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**